



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2019:242273

Datë: 20.07.2020

Numri i dokumentit: 01031601

**P. nr. 1017/19**

**NË EMËR TË POPULLIT**

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm, sipas gjykatësit të vetëm gjykues Luljete Shabani, në çështjen penale kundër të akuzurit A.R nga fsh. ..., K. e Gjilanit, për shkak të veprës penale, Sulmi ndaj personit zyrtar, nga neni 402 paragrafi 3 lihur me par.1 të KPRK-së, e sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, PP. II nr. 1731/19, të datës 23.10.2019, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, oral dhe publik, më datën 26.06.2020, bie dhe në prezencë të palëve, publikisht shpall, ndërsa, më dt. 20.07.2019, përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

I akuzuari A.R, me nr. personal ....., nga babai B... dhe nëna K..., e lindur M..., i lindur më datë ....., jeton në fsh. ...., K. e Gjilanit, i martuar, baba i tre fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, punëtor, i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i padënuar më parë, nuk zhvillohet procedurë tjetër penale ndaj tij,

**Ë S H T Ë F A J T O R**

Sepse, më datën 22.10.2019, rreth orës 15:00 minuta, në fsh. ..., kishte sulmuar punëtorët e KEDS-it gjatë një rikyqje në shtëpinë e tij, ashtu që fillimisht kishte fyer ata me fjalë fyese dhe gjatë fjalosjes e kishte sulmuar me duar thatë viktimën N.S, duke e kapur për fyti dhe duke e shtyer, ku pastaj, kanë ndërhyrë zyrtarët policorë dhe e kanë arrestuar deh shoqëruar në Stacionin Policor në Zhegër , ku i njejt, gjstë arrestimit kishte rezistuar fizikisht dhe kishte përdorë fjalë fyese, si: “ta q... shtetin”, me ç’rast, nga lëndimet e shkaktuara, i dëmtuari N.S është detyruar të marrë tretman mjeksor fillimisht në Q.M.F. Zhegër dhe pastaj, në Qendrën Emergjente në Gjilan, gjë që dëshmohet me raportin mjeksor me nr. 26110,

- me çka ka kryer veprën penale Sulmi ndaj personit zyrtar, nga neni 402 par. 3 lidhur me par./1 të KPRK-së, andaj, Gjykata në bazë të dispozitave të neneve 7, 17, 21, 51, 73, 11 të KPRK-së dhe nenit 365, 453 dhe 463 të KPPRK-së

## **E G J Y K O N** **ME DËNIM ME KUSHT**

Të akuzuarin A.R, me dënim burgu në kohëzgjatje prej **6 (gjashtë) muajve**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në kohën **1 (një) viti, e 6 (jashtë) muajve** nuk kryen vepër tjetër penale, në të kundërtën gjykata dënimin me kusht do ta revokojë.

Obligohet i akuzuari që ta paguajë paushallin gjyqësor në shumë prej **10 (dhjetë) €** si dhe shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të Gjykatës, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Pala e dëmtuar, udhëzohet **në kontest juridiko-civil**, për realizimin e kërkesës pasurore juridike.

### **A r s y e t i m**

2731/19, të datës 12.11.2019, kundër të akuzuarit A.R, për shkak të veprës penale, Sulmi ndaj personit zyrtar, nga neni 402 par.3 lidhur me par.1 të KPRK-së dhe ka kërkuar që të njëjtin ta shpallë fajtor dhe ta dënojë me dënim merititor.

Meqenëse i akuzuari e pranoi fajsinë për kryerjen e veprës penale e cila i vihet në barrë, pranim i cili është bërë në mënyrë vullnetare, pa presion, i njoftuar nga ana e gjykatës për pasojat dhe benefitet e pranimit të fajsisë, nuk pati nevojë që të administrohen prova të tjera.

Gjykata analizoi provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës dhe me vet pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, i cili pranim është në përputhje të plotë me provat e tjera që gjenden në shkresat e lëndës, si, Raporti i shoëjtë, i dt. 2.10.2019, Raporti i Pilicisë me nr. 2019-CA-1273, i dt. 22.10.2019, raporti fillestar i incidentiti, me nr. dhe datë të njëjtë. Raportet e oficerëve, deklarata e të dëmtuarit, e dhënë në Stacionin Policor në Gjilan, ë dt. 2.10 2019, deklaratat e dëshmitarëve, si dhe raportet mjeksore të të dëmtuarit N.S, me nr. 8285 , lëshuar nga QMF në Zhegër dhe raporti mjeksor me nr. 2610 i dt. 22.10 2019, lëshuar nga Emergjencia e Spitalit Regjional në Gjilan, si deh Ekspertiza mjeko-ligjore me nr. 2/11-19, e dt. 01.11.2019., erdhi në përfundim se i akuzuari A.R, e ka kryer veprën penale, **Sulmi ndaj personit zyrtar, nga neni 402 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së** .

Me rastin e caktimit të llojit dhe të lartësisë së dënimit Gjykata pati parasysh rrethanat të parapara me nenin 73 të KPRK-ës, dhe si rrethanë lehtësuese gjeti se i akuzuari e ka pranuar fajësinë, hera e parë që është ndeshur me ligjin, nuk e ka përsëritë më ndonjë vepër penale, si dhe i dëmtuari nuk i është bashkëngjitur ndjekjes penale dhe nuk ka kërkuar kompensim material, ndërsa si rrethanë rënduese pati parasysh shkallën e përgjegjësisë penale dhe rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale, me bindje se edhe me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit si në kuptim të nenit 41 të KPRK-ës.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është i bazuar në nenin 453 të KPPRK-së.

Nga të cekurat më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM  
P.nr. 1017/2019, më datë 20.07.2020**

**Gjykatësja e vetme gjykuese,  
Luljete Shabani**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë Departamenti i Përgjithshëm, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të së njëjtes. Ankesa dorëzohet në dy ekzemplarë, përmes kësaj Gjykate.